



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:263149

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06528752

C-IV-14-2298

Ankuesi

B K fshati H e M, Rahovec.

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 29 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ110-0003, datë 24 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 01 prill 2014, ankuesja (nëpërmjet postës) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ110-0003, të datës 24 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim nga NSH “Emin Duraku” në Gjakovë (*në likuidim*). Ankuesja pohon se parashtron ankesë kundër vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj lidhur me privatizimin e fabrikës “Emin Duraku” në Gjakovë. Ankuesja shton se vendimi i lartpërmendur ka arsye të pajustificuara për refuzimin e kërkesës së saj të cilat me këtë ankesë i hedh poshtë plotësisht. Ankuesja më tej thekson se vendimi i referohet shkresës së AL datë 31 tetor 2013, me të cilin i është kërkuar asaj që të jap prova përkatëse shtesë, të cilën e kam pranuar, i jam përgjigjur në kohë dhe brenda afatit të kërkuar duke dhënë informacionet shtesë të kërkuara të cilin e vërteton me konfirmimin në fjalë. Ankuesja më tej shton se pranon letra të ndryshme nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, e sheh të arsyeshme që me qëllim të zgjidhjes së këtij rasti të gjitha

përgjigjet dhe deklaratat e saj nga ankesa të vërtetohen si prova të bazuara dhe relevante. Ankuesja i propozon gjykatës që nga gjithçka që ka paraqitur, ankesa e saj të pranohet si e bazuar dhe lënda e saj të vazhdoj dhe të zgjidhet sipas procedurës së rregullt. Ankuesja në mbështetje të ankesës së saj ka bashkëngjitur vetëm dëftesën për pranimin e dërgesës datë 13 nëntor 2013.

Me 18 tetor 2024, AKP-ja parashtrori mbrojtjen e saj kundër ankesës, në të cilën thekson se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, neni 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr. 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të nenit 74.2 të Ligjit nr. 06/L-086, ankesa në fjalë është e pabazuar. E paditura më tej thekson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara në ligj dhe të parashkruara. Neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në parashikon: “... *elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë*”. Prandaj, AL e refuzon këtë kërkesë si të pavlefshme. Si përfundim, e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.2 të Ligjit nr. 06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj, ka bashkëngjitur vendimin e kundërshtuar, Formularët e Kërkesës së dorëzuar në procedurë të likuidimit, Njoftimin e AKP për fillimin e likuidimit të NSH, njoftimin për kreditorët, publikuar në shtypin ditor datë 11 shtator 2013, letërnjoftimin e ankueses, librezën e saj të punës, Shkresën / kërkesën për Informacione / dëshmi shtesë dërguar ankueses datë 30 tetor 2013, fletë kthesën postare, shkresën e zyrës së BE-së në Beograd, drejtuar Njësisë së Kërkesave të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) datë 9 nëntor 2006 së bashku me dëshmitë përcjellëse të kërkesës së ankueses.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata konstaton se, ankuesja në ankesën e saj kundër vendimit të kundërshtuar, vetëm i është referuar faktit se ajo ka dorëzuar kërkesat e saj dhe se vendimi i lartpërmendur ka arsye të pajustificuara për refuzimin e kërkesës së saj të cilat me këtë ankesë i hedh poshtë plotësisht. Mbi këtë bazë, ankuesja pretendon se konstatimet e të paditurës përkatësisht refuzimi i kërkesës së saj në mungesë të dëshmive apo informacioneve është i pasaktë, pasi ajo i është përgjigjur në kohë dhe brenda afatit të caktuar kërkesës së të paditurës për informacione dhe dëshmi shtesë. Në lidhje me këtë gjykata konsideron se pretendimet e tilla që mbështeten në një dëshmi të vetme dhe atë rreth komunikimeve të saj me të paditurën janë të pamjaftueshme për të mbështetur çfarëdo pretendimi.

Duke u nisur nga kjo gjendje, gjykata konstaton se ankesa mbetet plotësisht e paqartë edhe pas urdhrin të gjykatës dhe nuk ka asnjë dëshmi relevante, mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj për kërkesat e saj. Nga formularët në fjalë e veçanërisht formulari i datë 1 mars 2006 dorëzuar në zyrën e BE-së në Beograd, e cila është dorëzuar si provë nga e paditura shihet se ankuesja nuk ka kërkuar asnjë shumë specifike dhe nuk ka saktësuar as periudhë kohore për kërkesat e saj për kompensim për paga të papaguara apo pretendime tjera.

Prandaj, ankuesja me asnjë dëshmi nuk mbështet pretendimet e saj për paga të papaguara dhe kompensime tjera. Për më tepër, siç mund të konstatohet nga shkresat e lëndës, ankuesja nuk ka parashtruar prova relevante as në procedurën e likuidimit tek AL, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesave të saj në lidhje pagat e papaguara si dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shumën e as lidhur me llogaritjen e pagave, e as për periudhën kohore për pagat e kërkuara.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj për kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Për më tepër, ankuesja ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj edhe pas dorëzimit të urdhrin të gjykatës për precizim të ankesës dhe dorëzim të provave relevante në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar